

GJL nr.361/2012

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVAIRE-PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. i faq. Broj. stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	03-1308/2012
Data Datum Date	11.04.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Driart Elshani nga Prishtina, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr.regj.37299/11, datë 24.02.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 27.03.2012 merr

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është e **BAZUAR**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Ar sy e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Nr.regj.37299/11, të datës 24.02.2012, të pandehurin Driart Elshani nga Prishtina, e ka shpallur përgjegjës sepse si Drejtor i Departamentit për Qeverisje Elektronike në Ministrinë e Administratës Publike në Prishtinë, i zgjedhur më datën 07.06.2011, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njoftuar se është i përfshirë në Listën e Zyrtarëve, të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë me rastin e marrjes së funksionit, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1. dhe neni 16 paragrafi 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind).-€, duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë).- €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë në të cilën përpos tjerash thekson se asnjëherë nuk ka qenë i informuar me obligimin për deklarin,prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë sepse në detyrën e zyrtarit të lartë (drejtor i departamentit për qeverisje elektronike në Ministrinë e Administratës Publike) është zgjedhur më 07.06.2011 dhe nuk ka qenë i njoftuar për obligimin e lartcekur, se me mosdeklarim me kohë të pasurisë nuk ka pasur qëllim fshehjen e prejardhjes së pasurisë, por kjo ka ndodhur si rezultat i mosinformimit lidhur me këtë obligim. Më tutje thekson se kur është informuar për obligimin e tij për ta plotësuar formularin për deklarin e pasurisë, ky menjëherë ka vepruar ashtu që e ka plotësuar dhe dërguar në AKK më datën 28.10.2011 etj. andaj propozon që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe ky si i pandehur të lirohet nga përgjegjësia dhe gjoba e shqiptuar.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 23.01.2012 si dhe nga dëshmia e dëshmitares Bahrije Spanca të dhënë më datë 23.02.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesën e paraqitur nga i pandehuri e aprovoi si të bazuar, ndërkaq aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

03-1308/2012/02
Seny

2.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të mos vërtetimit të plotë të gjendjes faktike.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se i pandehuri e mohon ta ketë kryer kundërvajtjen e cila i ngarkohet derisa nga dëshmia e dëshmitares B.Spanca rezulton se e njëjta në afat ligjor e ka njoftuar të pandehurin për obligimin e deklarimit të pasurisë,por nga kjo deklaratë nuk mund të kuptohet se kurë dhe në ç'mënyrë e ka njoftuar të pandehurin. Shkresa e ofruar gjykatës sipas të cilës pretendohet që është njoftuar i pandehuri për obligimin e tij për deklarimin e pasurisë,rezulton se është njoftim për z.Agron Behrami i cili njoftohet se në kabinetin e ministrit të MAK janë plotësuar pozitat e theksuara dhe e njëjta shkresë nuk përmban asnjë datë. Rrjedhimisht, nga kjo shkresë nuk mund të dëshmohet se i pandehuri(për herë të parë i zgjedhur në pozitën e zyrtarit të lartë) është njoftuar siç parashihet në nen.4 pika 2.2 të Ligjit për deklarimin.prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë nr.04/L-050, kështu që konstatohet se në rastin konkret nuk është vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë.


Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë,të konstatoj se është njoftua apo jo i pandehuri për obligimin e deklarimit të pasurisë sipas mënyrës së paraparë me ligj, të administroj edhe prova tjera eventuale dhe më në fund varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Më sa u tha më lartë konform nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL.nr.361/2012, datë 27.03.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Çunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Dalip Bega